



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**OSNOVNI SUD U PRIZRENU - BASIC COURT OF PRIZREN**

---

**AD-GJTHPZ.nr.11/23**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, kryetarja e gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore parashtruar nga ana e ankuesit I.M.N."T....." me seli në Landovicë, Komuna e Prizrenit të cilën me autorizim e përfaqëson av. A.H., nga Prishtina, ndaj gjyqtarit G. Sh., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit të lartcekur sipas lëndës C.nr. 1525/20, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, **me dt. 11.05.2023 mori këtë:**

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET si e pabazuar** ankesa e ankuesit av. A.H., nga Prishtina, përfaqësuese e autorizuar e të paditurit I.M.N."T.," me seli në Landovicë, Komuna e Prizrenit, e paraqitur ndaj gjyqtarit G. Sh., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil.

### **A r s y e t i m**

Parashtruesja e ankesës av. A.H., nga Prishtina në cilësinë e përfaqësueses së autorizuar e të paditurit I.M.N."T.," me seli në Landovicë, Komuna e Prizrenit, në ankesën e saj ndaj gjyqtarit G. Sh., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren në Departamentin e Përgjithshëm- Divizioni Civil ka cekur se gjyqtari gjatë procedimit të çështjes C.nr.1525/20 në vazhdimësi ka bërë shkelje disiplinore me element të veprës penale keqpërdorim të detyrës zyrtare duke i bërë favore palës paditëse. Sipas av. A.H., gjyqtari ka shkelur dispozitat ligjore nge neni 5 par. 1 nënpar.1.3, nenit 2 par.2.1 , par.2.2dhe par.2.5 të Ligjit nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sipas ankueses, në kuadër të këtyre shkeljeve gjyqtari nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabartë palët në procedurë, nuk ka vendosur në tërësi për kërkesën e palës së paditur, nuk është përgjigjur në kërkesën për nxjerrjen e provës, respektivisht ka vendosur në mënyrë parciale për parashtruesat e palës së paditur dhe ka favorizuar palën paditëse me qëllim të përfitimit material. Me tutje, ankuesja ka shtuar se gjyqtari ka shkelur dispozitat e nenit 5 par. 1 nënpar. 1.3 dhe nenit 2 par.2 nënpar.2.1, par.2.2 dhe par. 2.5 dhe nenit 2.8 të Ligjit nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve ku me veprimet e tija ka ndikuar në favorizimin e palës paditëse duke ndikuar në verdiktin përfundimtar. Gjithashtu sipas ankesës gjyqtari ka shkelur dispozitat e nenit 5 par. 1 nënpar. I .3 dhe nenit 2 par.2 nënpar.2.1, par.2.2 dhe par. 2.5 , nenit 2.7 dhe 2.8 të Ligjit nr. 06/L-057 dhe nenit 7 par. 7.2 të LPKsë duke mos proceduar çështjen me kohë, duke shtypur vendimin retroaktiv, duke mos trajtuar dhe analizuar deklaratimet e ekspertëve, duke mos trajtuar dhe vërtetuar faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur (sipas detyrës zyrtare). Nga e gjithë kjo linden pyetjet dhe dyshimet se pse provat e palës paditëse janë të rëndësishme së lartë kurse

provat të cilat janë në favor të palës së paditur duhej të eliminoreshin, nuk mund të konsiderohet kjo si pakujdesi e rëndë, por vjen në shprehje element i veprës penale keqpërdorimit të detyrës. AV. A.H., ka pohuar se gate seancës kur është dëgjuar ekspertit me.13.03.2023 ajo e ka incizuar me telefon deklaratën e ekspertit, pa lejen e gjykatës dhe këtë incizim ka dorëzuar në gjykatë së bashku me kërkesë për inicim të procedurës disiplinore. Sa i përket kërkesës për përjashtim të gjyqtarit në këtë çështje juridike avokatja H. ka cekur se ka konflikt interesi tek gjyqtari pasi që djali i axhës së përfaqësueses së të paditurës ka qenë në lidhje martesore me balldëskën (motrën e gruas së gjyqtarit) e cila martesë ka përfunduar me shumë zhurmë dhe për këtë gjyqtari është dashur që të paraqes këtë fakt me kohë dhe të përjashtohet në këtë çështje. Bazuar në të gjitha këto fakte av. A.H., ka kërkuar që gjyqtari G. Sh., të përjashtohet nga shqyrtimi i kësaj lënde dhe të caktohet një gjyqtar tjetër me integritet profesional të lartë dhe që ndaj këtij gjyqtari të iniciohen hetime për shkelje disiplinore.

Gjyqtari G. Sh., në deklaratën e dhënë lidhur me ankesën e avokates A.H., ka cekur se lënda Civile C.nr.1525/2020 i është caktuar atij në punë pasi që kjo lëndë është vendosur një herë dhe është kthyer në rigjykim. Lëndën e ka pasur gjyqtari A.H., dhe ka qenë evidentuar me numër C.nr.373/2016. Sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit lënda është kthyer në rigjykim me dt. 21.09.2020 dhe duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me lëndën e cila është në rigjykim sipas LPK —së dhe Strategjisë së KGJK kjo lëndë është me prioritet dhe duhet të caktohet dhe të procedohet. Bazuar në këtë seanca është caktuar me dt. 19.04.2021 ku kanë prezantuar i autorizuari i paditësit av. A.D., nga Prishtina, i autorizuari i të paditurës së parë av..V.H., nga Prishtina si dhe i autorizuari i të paditurës së dytë av. V.R., nga Prishtina. Më pas janë caktuar edhe disa seanca ku janë administruar provat, janë dëgjuar ekspertët me avokatët e lartcekur. Tutje gjyqtari ka shtuar se në seancën e dt. 13.07.2021 avokati A.D., ka propozuar që të merret prova me super ekspertizë dhe i autorizuari i të paditurës së "T.," av.V.H., në parim e ka kundërshtuar marrjen e kësaj prove dhe njëherit ka kërkuar që kjo seancë të shtyhet me qëllim të arritjes së marrëveshjes në mes të palëve. Gjyqtari e ka aprovuar këtë kërkesë dhe seanca është shtyrë. Në ndërkohë e paditura e dytë KS "....." i është nënshtruar procedurës së likuidimit dhe gjykata ka ndërprerë procedurën ndaj të njëjtit. Palët janë deklaruar se nuk ka marrëveshje dhe seancat kanë vazhduar. Në seancën e radhës me dt.25.10.2021 gjyqtari ka aprovuar kërkesën për super ekspertizë pasi që ka pasur dy ekspertiza të ndryshme dhe i autorizuari i të paditurës në parim nuk ka kundërshtuar këtë propozim por në fund i ka lënë gjykatës në diskrecion të vendosjes. Gjyqtari ka vepruar në bazë të nenit 357.1 , 357.2 dhe 357.3 të LPK —së dhe ka aprovuar propozimin për super ekspertizë. Avokatja A.H., është bashkëngjiti si e autorizuar e të paditurës "T.," me autorizim të dt. 17.11.2021, pra pasi që është vendosur për marrjen e provës me super ekspertizë. Me angazhimin e avokates H., gjykata ka aprovuar edhe propozimet e palës të cilën ajo e përfaqëson, ka aprovuar kërkesat për shtyerje të gjykimeve, kurse ka refuzuar propozimet të cilat nuk janë të bazuar në ligj. Gjithashtu, gjyqtari ka deklaruar se në seancë të dt. 13.03.2023 avokatja është munduar të pengojë punën e gjykatës me mos mbajtjen e rendit dhe qetësisë për çka edhe i është tërhequr vërejtja e cila është konstatuar në procesverbal. Gjyqtari G. Sh., ka cekur se ai gjatë gjithë procedurës i ka trajtuar palët në mënyrë të barabartë, nuk ka pasur komunikim ex-parte dhe ka caktuar seanca të rregullta me qëllim të përfundimit të çështjes e cila është me prioritet dhe të natyrës urgjente. Avokatja A.H., gjatë gjithë kohës ka tentuar të prolongojë këtë çështje dhe ka bërë shkelje të Kodit të etikës së OAK duke incizuar ekspertin në seancë pa lejen e gjyqtarit. Sa i përket kërkesës për përjashtim e autorizuar e të paditurës asnjëherë nuk e ka cekur se ka gjini të krushqisë sepse motra e gruas së tij ka qenë shumë shkurt me djalin e axhës së avokates dhe nuk ka mundur me ditë se ka lidhje krushqie në mes tyre.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesën drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë

disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes G. Sh., ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës C.nr.2525/2020 dhe pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme Autoriteti Kompetent konsideron se:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon:

Në lëndën civile C.nr.1525/2020(373/16) pala paditëse është M.Th.,nga fshati Sërbice e Ultë të cilin me autorizim fillimisht e përfaqëson ICS Assistance IIIC Prishtina me av. B.N., kundër të paditurës së parë IMN "T.," SHPK Landovicë Prizren të cilin fillimisht e ka përfaqësuar av. F.Sh., autorizim zëvendësues nga avokati S.M., nga Prizreni dhe e paditura e dytë KS "....." nga Prishtina për kompensim dëmi. Lënda në fillim i është caktuar gjyqtarit A.H., i cili ka vendosur me Aktgjykim me dt. 16.05.2017. Sipas ankesës së palëve lënda nga ana e Gjykatës së Apelit është kthyer në rigjykim dhe lënda i është ndarë gjyqtarit G. Sh., pasi që gjyqtari paraprak është avancuar në Gjykatën e Apelit. Bazuar në strategiinë e KGJK-së lëndët që kthehen në rigjykim konsiderohen me prioritet dhe duhet të caktohen me urgjencë dhe duke respektuar këtë parim gjyqtari ka caktuar shqyrtimin përgatitor. Në këtë shqyrtim si i autorizuar i palës paditëse tani është av.A.D., , për të paditurën e parë "T.," avokati V.H., dhe për të paditurën e dytë "....." i autorizuari V.R.,. Duke u bazuar në vërejtjet e Gjykatës së Apelit gjyqtari ka aprovuar propozimin për angazhim të ekspertit nga lëmia e sigurisë në punë. Pas pranimit të ekspertizës është caktuar seanca e radhës, është lexuar ekspertiza, është dëgjuar eksperti nga lëmia e punës. Në këtë seancë i autorizuari i të paditurës "T., " av. V.H., ka pasur vërejtje për ekspertizën e ekspertit dhe propozuar që të angazhohet edhe një ekspert dhe të merret edhe një ekspertizë nga lëmia e sigurisë në punës, të cilin propozim e ka aprovuar gjyqtari dhe ka caktuar një ekspert nga lista e ekspertëve të gjykatës. Kjo na vërteton se gjyqtari ka aprovuar edhe propozimet e palës së paditur. Pasi që është caktuar eksperti dhe është pranuar ekspertiza është mbajtur seanca e dt. 13.07.2021. Pas leximit të ekspertizës dhe dëgjimit të ekspertit i autorizuari i paditësit ka pasur vërejtje se kemi dy ekspertiza kontradiktore dhe ka propozuar që të caktohet Super ekspertiza. I autorizuari i të paditurës av. V.H.; ka kundërshtuar në parim këtë propozim, por ka kërkuar që seanca të shtyhet në mënyrë që të provojnë të arrijnë marrëveshje jashtëgjyqësore në këtë çështje. Gjykata ka aprovuar që të dy propozimet. Në seancën e radhës gjykata ka ndërpre procedurën ndaj të paditurës së dytë ..... për shkak te likuidimit. Avokatja A.H., autorizimin si e autorizuar e të paditurës "T.," SHPK e ka dorëzuar me dt. 17.11.2021, ku që në fillim avokatja H., ka kundërshtuar caktimin e super ekspertizës dhe ka kërkuar që gjykata ta anulojë vendim e caktimit të këtyre ekspertëve. Gjykata e ka refuzuar këtë propozim. Në këtë fazë avokatja A.H., ka pranuar autorizimin dhe pas kësaj janë caktuar edhe 7 seanca, ku disa prej tyre janë shtyrë për arsye se një herë gjyqtari ka qenë i sëmurë me COVID - 19, herën tjetër avokatja A.H., ka kërkuar shtyrjen e seancës me arsyen e njëjtë se është me COVID-19. Gjatë tërë kohës avokatja A.H., ka kërkuar revokimin e aktvendimit për caktimin e ekspertëve, duke cekur se eksperti nuk i ka përmbushur obligimet ligjore nga neni 359 i LPK-së dhe se ka tentuar që të merr një ekspertizë në favor të paditësit, duke mos respektuar propozimet e të paditurit dhe udhëzimet e Gjykatës. Gjithashtu ka propozuar që të dëgjohen dy dëshmitarë të cilin propozim edhe e ka aprovuar Gjykata, ashtu që seancat e radhës janë zhvilluar me dëgjimin e dëshmitarëve, ekspertëve dhe shqyrtimi i fundit është mbajtur me datë 31.03.2023. AV. A.H., pasi që i është propozuar ky propozim ka kërkuar që shqyrtimi të ndërpritet sepse nuk mund të vazhdohet kjo procedurë dhe ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit me pretendim se është duke e përdorur autoritetin e tij në dobi të paditësit.

Autoriteti Kompetent, vlerëson se pretendimet e ankueses nuk qëndrojnë dhe në rastin konkret nuk ka shkelje disiplinore gjatë zhvillimit të procedurës dhe gjatë seancave të mbajtura

gjyqtari ka vepruar sipas autorizimeve duke zbatuar Ligjin e Procedurës Kontestimore. Pretendimet e ankueses se nuk janë respektuar të drejtat dhe kërkesat e tyre giatë seancave nuk qëndrojnë, për faktin se nga shkresat e lëndës vërtetohet se janë aprovuar disa propozime si të palës paditëse ashtu edhe të palës së paditur, këtu ankuesit, dhe se gjyqtari i çështjes e ka në diskrecion të tij të lirë udhëheqjen e procedurës dhe zgjidhjen e çështjes deri në përfundim, çdo herë brenda autorizimeve sipas ligjit. Pala e paditur, në rastin konkret pas përfundimit të procedurës ka të drejtë ankese për të gjitha veprimet procedurale të cilat janë marrë nga ana e Gjyqtarit gjatë kësaj procedure. Vendimi i gjyqtarit të shkallës së parë nuk është përfundimtarë dhe ka mjete të rregullta dhe të jashtëzakonshme me të cilat mund të atakohet ky vendim.

Vlen të theksohet se sipas deklaratës së avokates A.H., ka pohuar faktin se ka incizuar ekspertin gjatë dhënies së deklaratës së tij në seancë pa lejen e gjykatës gjë që është në kundërshtim me etikën e avokatëve dhe konsiderohet shkelje.

Ndërsa, sa i përket kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit e cila është paraqitur së bashku me kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore, Gjykata do të vendos me aktvendim të veçantë.

Për arsyet që u cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**AD-GJTHPZ.nr.11/2023, me dt. 11.05.2023**



**KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi, nuk e lejuar e drejta e ankesës.**